



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 512 Prot.

Tiranë, më 21.01.2025

UDHËZIM

Nr. 4, Datë 21.01.2025

PËR

NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 19.2.2018 “PËR GJENERIMIN DHE DHËNIEN E NUMRAVE TË MATRIKULLIMIT”, I NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 10, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe urdhrit nr. 113 datë 26.3.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të Zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar”,

UDHËZ O J:

1. Në udhëzimin nr. 6, datë 19.2.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”, i ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) Pika 7 ndryshohet si vijon:

“7. IAL-të, nëpërmjet ndërveprimit me sistemin SMIAL, dërgojnë në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar, për çdo cikël studimi, në përputhje me afatet e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin, që përcakton procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në IAL, sipas shtojcës nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

b) Pas pikës 9, shtohet pika 9/1 me përmbajtje si më poshtë:

“9/1. Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga institucioni përgjegjës, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre dhe të dhënat pasqyrohen në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL).”

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

